

I nderuar Ministër Likaj,

E nderuara znj. Hoxha,

Të nderuara Media,

Të nderuara të pranishëm,

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është e angazhuar që të punoj në nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Sektori financiar është një ndër kontribuuesit kryesorë në ekonominë e Kosovës. Megjithatë avancimi i tregjeve financiare, globalizimi dhe progresi teknologjik, kanë ndikuar që konsumatorët të ballafaqohen me një larmi instrumentesh financiare komplekse të cilat sot ofrohen në tregun financiar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës përmes Programit të saj për Edukim Financiar synon që të ngritë njohuritë financiare te publiku dhe të kontribuoj në zgjerimin dhe shpërndarjen e informatave për çështje ekonomike e financiare duke përfshirë e bashkëpunuar me institucione relevante, me qëllim që të kemi shtrirje sa më të gjerë të shpërndarjes së njohurive.

Edukimi Financiar është fushë të cilën Banka Qendrore e Republikës së Kosovës e ka iniciuar në Kosovë, ka punuar dhe ka investuar për ta avancuar tash e sa vite. BQK konsideron që duke avancuar e investuar në fushën e edukimit financiar në mënyrë të drejtpërdrejt kontribuon që qytetaret e Kosovës të kenë njohuri në marrjen e vendimeve të drejta me mjetet e tyre financiare. Sa më të informuar e edukuar financiarisht të jenë qytetaret aq më të aftë do të jenë në ngritjen e mirëqenies së tyre ekonomike e financiare si dhe në përdorimin dhe shfrytëzimin e duhur të sistemit financiar.

Objektivë e Programit të Edukimit Financiar të BQK-se është që me aktivitetet dhe materialet edukative të targetojë të gjitha grupmoshat e qytetarëve të Kosovës, megjithatë fokus primar ka nxënësit e të gjitha niveleve të arsimit në Kosovë. Krijimi i shprehive adekuate për menaxhimin e të hollave krahasohet me krijimin e shprehive esenciale të jetës. Rrjedhimisht institucionalizimi i edukimit financiar në Shkollë është hap tejet i rëndësishëm. Në këtë mënyrë do të arrijmë që të sigurojmë qëndrueshmëri, vazhdimësi e sukses në instalimin e një kulture të mirëfilltë financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, dhe e përkrahur financiarisht nga Fondi për Evropën Juglindore, EFSE (Finance in Motion Zyra në Kosovë), ka arritur që të përgatitë një koleksion prej 5 Librave.

Projekti i **Koleksionit të Librave** ka për qëllim që të kontribuohet në të informuarit dhe edukimin e nxënësve të shkollave fillore me koncepte bazike financiare të cilat do t'i përcjellin gjatë tërë jetës së tyre pa marrë parasysh profesionin apo drejtimin që ata do e përzgjedhin në të ardhmen.

Tekstet janë përgatitur, nga Ekspertë përkatës të fushës, tekstshkrues dhe ilustrator, në pajtueshmëri me Kurrikulën bërthamë për arsimin fillor të Kosovës dhe përbehet nga pesë libra me tregime për fëmijë të moshave 6-10 vjeç, përkatësisht për nxënësit e klasave I – V, të arsimit fillor. Fokusi i librave është edukimi financiar ku përmes këtyre librave, fëmijët kanë mundësi të

mësojnë në lidhje me tema financiare bazike, të studiuara dhe të përzgjedhura për moshat përkatëse, gjithmonë bazuar në standardet e rekomanduara nga OECD. Përveç formës së shkruar librat janë përgatitur dhe me zë në mënyrë që të jenë të përshtatshme edhe për fëmijët e verbër apo me të pame të dobësuar.

Librat do të shpërndahen në formë fizike nëpër shkollat fillore të të gjitha Komunave të Kosovës, në formë elektronike përmes kanaleve të komunikimit në BQK-së dhe me Shoqatën/Shkollën e të Verbërve të Kosovës.

Përfshirja e edukimit financiar në kurrikulën zyrtare shkollore është mënyra më efektive, e qëndrueshme, dhe afatgjatë për të arritur që njohuritë dhe shkathtësitë financiare të mësohen e zhvillohen në mënyrë të duhur dhe nga të gjitha gjeneratat në nivel vendi.

Edukimi financiar tashmë është pjesë e kurrikulave të shumicës së vendeve të rajonit, shteteve të Evropës dhe botës.

Nxënësit e Kosovës sikurse edhe nxënësit e të gjitha vendeve tjera të botës tashmë janë pjesë e vlerësimeve të realizuara nga Organizata për bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në kuadër të PISA's, e ku kapitull i veçantë bën pjesë edhe vlerësimi i njohurive në fushën e edukimit financiar.

Të nderuar pjesëmarrës, pothuajse të gjitha iniciativat dhe realizimi i aktiviteteve të BQK-se me nxënës të të gjitha niveleve dhe studentë të Universiteteve do të ishte i pamundur pa përkrahjen e MASH-it. Bashkëpunimi i BQK-se me MASH-in për fushën e edukimit financiar ka vite që vazhdon, ndërsa sot falë përkushtimit dhe përkrahjes së Ministrit Likaj, shënohet një hap shumë i rëndësishëm, nënshkrimi i Memorandumi të Bashkëpunimi për përfshirjen e kësaj fushe në Kurrikulën Shkollore. Dy Institucione tona do të punojnë për së afërmi që të vendosin rreth mënyrës adekuate të përfshirjes së kësaj fushe. Detajet rreth volumit dhe nivelit të përfshirjes mbetet të shikohen e realizohen në vazhdim në mes të dy Institucioneve tona.

Një bashkëpunim tejet crucial për Edukimin Financiar është bashkëpunimi jonë me Fondin për Evropën Juglindore (Finance in Motion-EFSE), Zyrën në Kosovë. EFSE na ndihmuan e përkrahën në ndërtimin e Programit të Edukimit Financiar dhe po vazhdojnë të na përkrahin në implementimin e shtyllave të këtij Programi. Projekti i koleksionit të Librave u bë i mundur të realizohet falë përkrahjes financiare dhe angazhimit të EFSE's.

Te nderuara media, me lejoni që në emrin tim personal por edhe në emër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të ju falënderoj juve për përcjelljen e aktiviteteve e ngjarjeve të cilat BQK i organizon çdo vit e që anjehere nuk ka munguar përkrahja dhe prezenca e juaj. Kjo ka rëndësi të veçantë në përcjellimin e mesazheve informuese e edukative të publiku Kosovar.